



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**



Nr. 1476 Regj.  
Nr. 1476/4 Prot.

Tiranë, më 23/12/2021

**URDHËR**

**“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”**

Drejtuar : QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Per dijani Debitor: NEW OPPORTUNITIES sh.p.k

Per dijani kreditorit MVR sh.p.k

Pranë Zyrës së Përmbarrimit Gjyqësor Privat “JUS” sh.p.k me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarrimore me numër Regj 1476 me palë:

Kreditor: SHOQËRIA “MVR” SH.P.K NIPT: L91609017K

Debitor: NEW OPPORTUNITIES NIPT: NUIS L71507037J

Objekti: Pagim faturash

Unë përmbarruesi gjyqësor Marib Hasanlliu pasi shqyrtova materialin e plotë të dosjes përmbarrimore:

**KONSTATOVA:**

Në titullin ekzekutiv: **Vendimi nr. 17916 datë 16.12.2021** lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është përcaktuar detyrimi **NEW OPPORTUNITIES NIPT: L71507037J** si palë debitore ti paguaj kreditorit **SHOQËRIA “MVR” SH.P.K NIPT: L91609017K** shumën prej **4,346,000 (katër milion e treqind e dyzet e gjashtë mijë) lekë në fatura të pashlyera, si dhe kamatëvonesat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi për Faturën Tatimore me Nr. 93639610 datë 16.09.2020, në vlerën 1.992.000 lekë, Faturën Tatimore me Nr. 93639616 datë 20.09.2020, në vlerën 1.998.000 lekë. Faturën Tatimore me Nr. 93639604 datë 03.09.2020, në vlerën e mbetur 356.000 lekë Kamatëvonesat për faturat e pashlyera janë llogaritur deri në datën 21.12.2021, nga ekspert kontabel i certifikuar, në vlerën **440.186 lekë** Tarifa përmbarrimore për shumën totale të detyrimit është në masën **382.895 lekë**. Tarifa për akt- përlllogaritjen e kamatvonesave është në masën **40.000 lekë****



**Për këtë arsye :**

Në bazë të neneve **519 te K.Pr.Civile, 527, 593 e në vijim të K.Pr.Civile e U. B. Sh** "Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në Banka"

**URDHËROJ:**

**1- Qendra Kombëtare e Biznesit** brenda 10-ditësh nga marrja dijani, të verifikojë nëse ekzistojnë kuota/aksione/aktive dhe biznese të regjistruara në emër të :

- **NEW OPPORTUNITIES NUIS L71507037J** me administrator *Shkëlqim Llaçi*
- **BLU COLOR SRL ALBANIA NUIS: L72412038S** me administrator *Shkëlqim Llaçi*

dhe nëse ka të tilla të kryejnë vendosjen e sekuestros mbi kuotat dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i kuotave për shumën e detyrimit prej: **5.209.081 (pesë milion e dyqind e nëntë mijë e tetëdhjetë e një) lekë**

**2-** Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet te na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

**3-** Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren të gjitha masat e parashikuara në nenin **598 e në vijim te K.Pr.Civile**, si dhe në rast se ka vend do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

**PËRMBARUES GJYQËSOR**

**Mario HASANLLIU**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 1476 Regj.  
Nr. 1476/3 Prot.

Tiranë, më 23.12.2021

**LAJMËRIM**  
**PËR EKZEKUTIM TË DETYRUESHËM**

**Drejtuar: "NEW OPPORTUNITIES" sh.p.k**  
*Adresa: Lagja nr. 1, rruga Polican, Godina 3 Kamez, Tirane*

**Për dijjeni Kreditorit: Shoqëria "MVR" sh.p.k**  
*Adresa: Rruga Komuna e Parisit, Pallatet 1 Maj, Apartamenti nr. 125, Shkalla nr. 7*

Pranë Zyrës së Përmbarrimit Gjyqësor Privat "JUS" sh.p.k me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarrimore me numër Regj 1476 me palë:

**Kreditor: SHOQËRIA "MVR" SH.P.K NIPT: L91609017K**  
**Debitor: NEW OPPORTUNITIES NIPT: NUIS L71507037J**  
**Objekti: Pagim faturash**

Une përmbaruesi gjyqësor Mario Hasanlliu pasi shqyrtova materialin e plotë të dosjes përmbarrimore

**KONSTATOVA:**

Në titullin ekzekutiv: **Vendimi nr. 17916 datë 16.12.2021 lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë** është përcaktuar detyrimi juaj si palë debitore ti paguani kreditorit shumën prej **4,346,000 (katër milion e treqind e dyzet e gjashtë mijë) lekë në fatura të pashlyera, si dhe kamatëvonesat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi për faturat si mëposhtë vijon:**

- Faturën Tatimore me Nr. 93639610 datë 16.09.2020, në vlerën 1.992.000 lekë
- Faturën Tatimore me Nr. 93639616 datë 20.09.2020, në vlerën 1.998.000 lekë
- Faturën Tatimore me Nr. 93639604 datë 03.09.2020, në vlerën e mbetur 356.000 lekë

Kamatëvonesat për faturat e pashlyera janë llogaritur deri në datën 21.12.2021, nga ekspert kontabel i certifikuar, në vlerën **440.186 lekë**

Tarifa përmbarrimore për shumën totale të detyrimit është në masën **382.895 lekë**

Tarifa për akt- përllogaritjen e kamatvonesave është në masën **40.000 lekë**



Për ekzekutim të vendimit gjyqësor të mësipërm pala debitore është lajmëruar që detyrimin ta përmbushë në mënyrë vullnetare me shkresën e dates 21.12.2021. Afati i ekzekutimit në mënyrë vullnetare ende nuk ka kaluar.

Të ndodhur para parashikimeve të nenit **519 të K.Pr.Civile** "Ekzekutimi i detyrueshëm nuk mund të fillojë para se të kenë kaluar afatet e parashikuara nga neni 517 i këtij Kodi, përveç kur ka rrezik se me kalimin e afatit, ekzekutimi do të bëhet i pamundshëm. Në këtë rast, përmbaruesi gjyqësor mund të fillojë menjëherë nga ekzekutimi i detyrueshëm" ekzekutimi i titullit do të vazhdojë në fazën procedurale të ekzekutimit të detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme të tij deri në masën që do të jetë e nevojshme për plotësim të detyrimit.

Për këtë arsye në bazë të neneve **519**, si dhe nenit **130, 525, 527**, të K.Pr.Civile.

#### URDHËROJ:

1- Kryerjen e titullit ekzekutiv: **Vendimi nr. 17916 datë 16.12.2021** lëshuar nga Gjykata e Rrethit **Gjyqësor Tiranë**, në shumën totale të detyrimit prej: **5.209.081 (pesë milion e dyqind e nëntë mijë e tetëdhjetë e një) lekë**

2- Derdhja e shumës do të kryhet në llogarinë e Shoqërisë Përmbaremore Private "JUS" sh.p.k pranë "RAIFFEISEN" BANK sh.a. në numrat e llogarisë:

- 0030362491 ( ALL), IBAN: AL 44 202 11 044 00000000 3036 2491 pranë "BANKES RAIFFEISEN" sh.a.
- 0040362491 (EURO), IBAN: AL 29 202 11 044 00000000 4036 2491 pranë "BANKES RAIFFEISEN" sh.a

3-Me marrjen e këtij njoftimi debitori detyrohet të deklarojë me shkrim gjendjen e tij pasurore si dhe për sende ose kredi që persona të tretë i detyrohen.

4-Refuzimi, kryerja në mënyrë të parregullt, mosrespektimi i afateve apo kryerja në kundërshtim me Vendimin e Gjykatës sanksionon debitorin me masa administrative dhe penale.

**PËRMBARUESI GJYQËSOR**

**Mario HASANLLIU**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr.1476 Regj.  
Nr 1476/5 Prot.

Tiranë, më 23.12.2021

**URDHËR**

**“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”**

**Drejtuar: Bankave të Nivelit të II**

*Bazuar në nenin 519, 594 të K.Pr.Civile urdhëroj vendosjen e sekuestros:*

· në llogarinë e debitorit **NEW OPPORTUNITIES NIPT: NUIS L71507037J** në shumën **5.209.081 (pesë milion e dyqind e nëntë mijë e tetëdhjetë e një) lekë**

· Referuar urdhërit ekzekutiv: **Vendimi nr. 17916 datë 16.12.2021** lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ku është përcaktuar detyrimi i palës debitore.

Sekuestro të vendoset brenda datës **25.12.2021** mbi shumën **568,320 (dy milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e treqind e njëzet)** dhe për shumat, të cilat do të bëhen të disponueshme në të ardhmen në llogari, deri në plotësimin e kësaj shume.

Njoftimi i vendosjes së sekuestros të dërgohet brenda datës **28.12.2021**

**PËRMBARUES GJYQËSOR**  
**Mario HASANLLIU**

